

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6186
E mërkurë, 9 dhjetor 2020
çmimi 0.40

Engeli kërkon nga Gjykata
Speciale t'i hetojë edhe
krimet e Serbisë të kryera
në Kosovë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS SHPREHET E GATSHME TA VAZHDOJË DIALOGUN ME SERBINË

NJOHËSIT E PROCESIVE POLITIKE:

DIALOGU ME SERBINË MOS TË NDËRLIDHET ME SPECIALEN | FAQE 4-5

Kryeministri Avdullah Hoti ka paralajmëruar vazhdimin e dialogut me Serbinë pavarësisht prej kundërshtimeve nga partnerja e koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). I pari i qeverisë ka treguar se ky proces pritet të vazhdojë më 10 dhjetor, në takim ndërmjet delegacioneve shtetërore të Kosovës dhe të Serbisë. Hoti ka thënë se beson se brenda disa muajve do të arrihet në fund të këtij procesi. Edhe njohësit e dialogut Kosovë - Serbi kanë thënë se Kosova duhet ta vazhdojë këtë proces dhe të mos e lidhë atë me punën e Gjykatës Speciale



OPINION

NDËRMJETËSUESI QË NUK
ULET NË MES | F. 11

Nga Valmir
ELEZI



KONSENSUSI POLITIK,
I DOMOSDOSHËM PËR
MENAXHIMIN E SITUATËS
QË ËSHTË E RËNDË! | F. 6

KMDLNj

AKTUALE



HOTI FTON VIKTIMAT E DHUNËS
SEKSUALE GJATË LUFTËS TË
APLIKOJNË PËR NJOHJE
TË STATUSIT | F. 7

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE
NË PRAKTIKË PROFESIONALE | F. 6

EKONOMI

NGA E PREMTJA QYTETARËT
MUND TË APLIKOJNË PËR
TËRHEQJEN E KURSIMEVE TË
TYRE PENSIONALE | F. 9

"TREPÇA" BLEN EKSPLOZIV
NË VLERË GJYSMË
MILIONI EURO | F. 8

LIMAJ BISEDON ME LAJÇAKUN, THEKSON NEVOJËN PËR UNITET PËR TEMAT KOMBËTARE | FAQE 3

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zhvilluar të martën një bisedë telefonike me përfaqësuesin special të BE-

së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë.

Limaj në bisedë me Lajçakun ka theksuar edhe një herë nevojën për unitet sa më të gjerë për temat kombëtare



ISH TË BURGOSURIT E VLERËSOJNË SI NISMË TË DUHUR
SHNDËRRIMIN E ISH-BURGUT TË PRISHTINËS NË MUZE | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV,
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Eurodeputetët, thirrje Këshillit Evropian: Shqipëria meriton të ecë përpara në rrugën drejt anëtarësimit në BE

TIRANË, 8 DHJETOR (ER) - Eurodeputetë nga grupet kryesore politike si dhe anëtarë të Komitetit të Politikës së Jashtme në Parlamentin Evropian i kanë bërë thirrje Këshillit Evropian për miratimin e kuadrit të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, në takimin e së martës të Ministrave të Çështjeve Evropiane.

Në deklaratën në fjalë, mbi Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, të nënshkruar nga më shumë se 20 eurodeputetë, përfaqësues të grupeve politike nxitën të gjitha palët e përfshira për gjetjen e një

zgjidhjeje për të siguruar që negociatat e pranimit të fillojnë para fundit të vitit.

Duke paralajmëruar se bllokimi aktual në bisedimet e pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë po rrezikon besueshmërinë e Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor, ata i bëjnë thirrje Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut të gjejnë një kompromis mbi çështjet dypalëshe në pritje për ta shmangur shtyrjen e procesit të pranimit më tej.

Mbi çështjen në fjalë ka reaguar edhe kreu i grupit parlamentar i PS-së, Taulant Balla, i cili citon një pjesë të



deklaratës. “Shqipëria e meriton të ecë përpara në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE”, vlerësojnë

eurodeputetët, duke nënvizuar përpjekjet e gjithanshme në reforma, në mënyrë të veçantë në fushën e

drejtësisë, gjatë viteve të fundit, sikurse vlerësohet edhe në vlerësimin e Komisionit Evropian.

Po kështu më tej në kërkesë shkruhet se: “Bullgaria duhet ta miratojë hapjen e konferencës ndërqeveritare (IGC) me Maqedoninë e Veriut sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast në dhjetor, duke pranuar kështu përpjekjet e vendit në procesin e pranimit në BE. Maqedonia e Veriut, në rolin e saj si një vend i ardhshëm i pranimit, gjithashtu duhet të bëjë çdo përpjekje të mundshme nga ana e saj për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura”.

Bregu: Një integrim ekonomik që nuk merr parasysh realitetet ekonomike, recetë drejt dështimit



BRUKSEL/SARAJEVË, 8 DHJETOR (ER) - “‘Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi rajonal’ janë dy anë të së njëjtës medalje. Tregjet e integruara mund të jenë pjesë e procesit të integritimit në BE. Por bashkëpunimi rajonal është më shumë sesa tregjet e integruara. Është një proces politik. Kjo është arsyeja pse plani i veprimit për tregun e përbashkët rajonal, i nënshkruar nga udhëheqësit e BP6, në Sofje muajin e kaluar, është një plan i mirë. Një integrim ekonomik që nuk merr parasysh realitetet

ekonomike, politike dhe sociale të gjitha së bashku është një recetë drejt dështimit. Prandaj, ne kemi punuar pikërisht në këtë kuadër për të qenë realist dhe i arritshëm”, ka deklaruar Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) në hapjen e Samitit të BE-Ballkanit Perëndimor “Friends of Europe” 2020.

Ajo ka thënë se kriza ndikon në dy perspektiva, në të brendshmen dhe të jashtmen. “Ndërkohë që pandemia e Covid-19 po riorganizon botën në mënyrë rrënjësore, duke na

bërë të gjithëve shumë vulnerabel dhe të brishtë, rajonalizimi mund të rritet si një rrugë alternative drejt zhvillimit. Sidoqoftë, këto përpjekje përballen me sfida dhe vonohen, ose disa braktisen për arsye nga më të ndryshmet. Hapat fillestarë, siç është integrimi më i thellë mes nesh, nuk mund të kenë sukses pa ndërmarrjen e hapave, të mëtejshëm, paralelë për integrimin e tregjeve tona në tregun e BE-së. Vetëm në këtë mënyrë qëllimet mund të rriten dhe procesi të konsiderohet i suksesshëm”, ka thënë Bregu.

Meta: Integrimi evropian i Shqipërisë kalon vetëm përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme

TIRANË, 8 DHJETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka zhvilluar një takim virtual me raportuesen e shtetit shqiptar në Parlamentin Evropian, Isabel Santos dhe ambasadorin e Bashkimit Evropian në Tiranë, Luigi Soreca. Gjatë këtij takimi Meta ka thënë se integrimi evropian i Shqipërisë kalon vetëm përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. “Kënaqësi të zhvilloja sot një

bashkëbisedim të sinqertë e miqësor me reporteren për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, eurodeputeten Isabel Santos, dhe ambasadorin e delegacionit të BE-së në Tiranë, zotin Luigi Soreca. Një falënderim i veçantë për zonjën Santos, për vëmendjen e posaçme që u ka kushtuar në Projektrezolutën për Shqipërinë zgjedhjeve të ardhshme, fenomenit të shpopullimit dhe cenimit të

lirisë së medias në Shqipëri. E sigurova se si president i Republikës do të vazhdoj të bëj çdo përpjekje për zbatimin e plotë të të gjitha kushteve që lidhen me nisjen e negociatave të anëtarësimit. Integrimi evropian i Shqipërisë kalon vetëm përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe ndërtimit të shtetit ligjor me institucione të pavarura dhe funksionale”, ka shkruar Meta në llogarinë e vet në “Facebook”.



Vaksinohet kundër Covid-19 personi i parë në Mbretërinë e Bashkuar



LONDËR, 8 DHJETOR - Një grua 90 vjeçe nga Irlanda e Veriut është bërë personi i parë në botë që ka marrë vaksinën e kompanisë “Pfizer / BioNTech” kundër Covid-19, duke shënuar fillimin e programit të vaksinimit masiv

në Mbretërinë e Bashkuar. Margaret Keenan, nga Enniskillen, tha se ndihej “aq e privilegjuar” për ta marrë vaksinën në Spitalin Universitar, Coventry. “Është dhurata më e mirë sepse do të

thotë që më në fund mund të pres dhe të kaloj kohë me familjen dhe miqtë e mi për Vitin e Ri, pasi isha vetë për pjesën më të madhe të vitit”, ka thënë ajo.

Qendrat shëndetësore në

Mbretërinë e Bashkuar do t'i vaksinonjë personat mbi 80 vjeç dhe disa pjesëtarë të personelit shëndetësor dhe të kujdesit. Programi synon t'i mbrojë grupet më të ndjeshme dhe ta kthejë jetën në normalitet.

17 viktima dhe 557 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë 17 persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 727 persona dhe janë paraqitur 557 raste të reja me Covid-19



Malishevë 5 raste, Shtime 5 raste, Kaçanik 3 raste, Mamushë 3 raste, Dragash 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Skenderaj 5 raste, Klinë 4 raste, Deçan 3 raste, Istog 3 raste, Graçanicë, Hani i Elezit, Ranillug, Shtërpcë”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Në 24 orët e fundit janë raportuar 17 viktima nga Covid-19 dhe 557 raste të reja pozitive. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka treguar se rastet e reja rezultojnë nga testimi i 1 541 mostrave. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 541 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 557 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 17 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren tri raste (67, 59, 49 vjeç), Prishtinë dy raste (81, 77 vjeç), Gjakovë dy raste (77, 74 vjeç), Rahovec dy raste (65, 63 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (64 vjeç), Pejë një rast (59 vjeç), Dragash një rast (91 vjeç), Viti një

rast (87 vjeç), Malishevë një rast (82 vjeç), Deçan një rast (60 vjeç), Gjilan një rast (68 vjeç), Vushtrri një rast (61 vjeç)”, ka njoftuar instituti.

Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 727 pacientë. “Numri total i rasteve pozitive është 43 881 raste nga 155 625 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 137 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 727 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 30.157 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12.587”, ka vlerësuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve nëpër komuna. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 217 raste, Mitrovicë 41 raste, Fushë-Kosovë 33 raste, Podujevë 33 raste, Gjakovë 25 raste, Gjilan 23 raste, Prizren 23 raste, Pejë 22 raste, Ferizaj 19 raste, Drenas 15 raste, Viti 15 raste, Vushtrri 13 raste, Obiliq 11 raste, Kamenicë 10 raste, Suharekë 10 raste, Lipjan 8 raste,

ShSKUK-ja për çështjen e oksigjenit: Vazhdojnë furnizimet krahas kërkesave dhe nevojave

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se ditët e fundit janë rritur kërkesat për furnizim me oksigjen. ShSKUK-ja nëpërmjet një njoftimi për media ka theksuar se institucionet shëndetësore vazhdojnë të furnizohen konform kërkesave dhe nevojave. “Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i

Kosovës njofton se për shkak të rritjes së numrit të pacientëve të spitalizuar, ka pasur kërkesa në rritje për furnizim me oksigjen dhe institucionet shëndetësore vazhdojnë të furnizohen konform kërkesave dhe nevojave”, ka njoftuar ShSKUK-ja. Më tutje, ShSKUK-ja ka theksuar se për transferimin e pacientëve për në QKUK nga

spitalet e tjera janë kompetentë mjekët. “Lidhur me trajtimin e pacientëve, mjekët janë profesionistë dhe kanë kompetencë të plotë të vendosin se në cilin stad pacientët transferohen për trajtim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si institucioni i vetëm terciar shëndetësor në vend”, ka njoftuar ShSKUK-ja.

Limaj bisedon me Lajçakun, thekson nevojën për unitet në temat nacionale

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zhvilluar të martën një bisedë telefonike me përfaqësuesin special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Limaj në bisedë me Lajçakun ka theksuar edhe një herë nevojën për unitet sa më të gjerë në temat nacionale

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zhvilluar të martën një bisedë telefonike me Miroslav Lajçakun, përfaqësues special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi. Me këtë rast, Limaj ka biseduar për sfidat që po kalon Kosova në këtë periudhë të ndjeshme. “Sapo zhvillova një bisedë telefonike me përfaqësuesin special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, z. Miroslav Lajçak. Biseduam për aktualitetin politik në vend, me sfidat që po kalon Kosova në këtë periudhë të ndjeshme e jo të lehtë për vendin, sidomos pas zhvillimeve në Dhomat e

Specializuara dhe përballjen me pandeminë”, ka deklaruar Limaj.

Sipas liderit të Nismës, Kosova ka nevojë për unitet politik. “Përfaqësuesin special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi e informova për zhvillimet politike në vend dhe të njëjtën kohë theksova edhe një herë nevojën për unitet sa më të gjerë në temat nacionale. Në këtë kontekst, u bisedua që Kosova të ecë në rrugën e saj në mënyrë që të tejkalohen sfidat që ka para vetes, në fokus të veçantë në rimëkëmbjen ekonomike si dhe dialogun Kosovë - Serbi”, është shprehur Limaj.



QEVERIA E KOSOVËS SHPREHET E GATSHME TA VAZHDOJË DIALOGUN ME SERBINË

NJOHËSIT E PROCESSEVE POLITIKE: DIALOGU ME SERBINË MOS TË NDËRLIDHET ME SPECIALEN

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar vazhdimin e dialogut me Serbinë pavarësisht prej kundërshtimeve nga partnerja e koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). I pari i qeverisë ka treguar se ky proces pritet të vazhdojë më 10 dhjetor, në takimin ndërmjet delegacioneve shtetërore të Kosovës dhe të Serbisë. Hoti ka thënë se beson se brenda disa muajve do të arrihet në fund të këtij procesi. Edhe njohësit e dialogut Kosovë - Serbi kanë thënë se Kosova duhet ta vazhdojë këtë proces dhe të mos e lidhë atë me punën e Gjykatës Speciale

dialogut, ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, i cili është edhe përfaqësues i AAK-së në këtë proces, ia kishte bërë kryeministrit edhe në mbledhje të qeverisë në fillim të muajit të kaluar. “Këto aktakuza, më shumë se efekt juridik, po prodhojnë efekt politik, për të cilën s’bën të qëndrojmë duarkryq. Konsideroj se Qeveria e Kosovës duhet ta pezullojë menjëherë dialogun deri në një moment tjetër. Dhomat e Specializuara kanë pranuar dosje të fabrikuara nga shërbimi sekret i Millosheviqit. Derisa nuk e bën të qartë se UÇK-ja nuk është një grup i organizuar kriminal atëherë brishtësia e sigurisë nacionale është e shprehur”, kishte thënë Selimi.

Mirëpo pretendimet e AAK-së kryeministri i kishte hedhur poshtë. Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë thënë se ky proces nuk duhet të ndërlihet me procesin e Gjykatës Speciale. Madje kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka thënë për “Epokën e re” se një ndërlihdje e tillë është naive. “Për mua është naiviteti i madh të lidhet dialogu me këto procese gjyqësore. A nuk e kemi ditur ne se një ditë gjykata do ta fillojë punën? A nuk e kemi ditur ne se Serbia me punën e saj të pandalshme qëndron prapa saj? A nuk i kemi ditur ne tash e 20 vjet

qëndrimet e Serbisë? Dialogu nuk duhet të lidhet me procese të tilla. Problemin që e kemi si shoqëri me dialogun është se asnjëherë nuk kemi qenë të bindur se dialogu është në dobinë tonë. Andaj edhe sillemi ndonjëherë si fëmijë të llastuar”, ka thënë Murati. Sipas tij, e rëndësishme është që liderët e Kosovës duhet të dinë se çka po duan nga ky dialog. “Puna është se politikanët tanë në diskursin e tyre rreth dialogut me një nëntekst që kuptohet lehtë e çojnë mesazhin se ne nuk e duam dialogun, por e bëjmë për shkak të aleatëve tanë. Andaj edhe ne pastaj nuk dimë se çfarë duam nga dialogu, nuk kemi një platformë të përpunuar politike dhe vetëm vazhdon mashtrimi i opinionit se po shkojmë në dialog për njohje”, ka thënë Murati.

Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, mendon se Kosova nuk duhet ta ndërpresë njëanshëm këtë proces. “Sjellja destruktive e Serbisë ka eskaluar edhe më shumë. E kam thënë këto ditë, se derisa e gjithë bota mendon se si të lehtësohet gjendja e popullatës nga pandemia, Serbia e ka mendjen te lufta. E ka shtuar retorikën e luftës, madje bën edhe anketa në këto drejtime, që tregon se problemi kryesor i Ballkanit është Serbia, pra faktor destabilizues i sponsorizuar edhe nga politikat destruktive ruse. Kjo për

Ballkanin është shqetësuese”, ka thënë ajo, duke shtuar se partnerët euroatlantikë si ShBA dhe partnerët evropianë duhet të mobilizohen që Ballkani të mos kthehet edhe një herë në një fushëbetejë të agjendave gjeopolitike. “Kur jemi te proceset euroatlantike, mendoj se Bashkimi Evropian tani duhet të mendojë shumë më shumë për Kosovën. Koha është që të liberalizohen vizat këtë vit dhe të mos shtyhet më tej ky proces, se me të vërtetë BE-ja ka rënë në provim para Kosovës sa i takon liberalizimit të vizave, por edhe të përshpejtohet procesi i hapjes së negociatave për anëtarësim për Kosovën. Pra t’i jepet statusi i kandidatit, sepse kjo është koha kur BE-ja mund të shtrijë një dorë më të fuqishme drejt Kosovës për ta mbështetur në proceset eurointegruese dhe euroatlantike”, është shprehur Tahiri.

Dialogu në Bruksel ka rinisur në muajin korrik të këtij viti, ku u mbajtën takimet e nivelit të lartë ndërmjet kryeministrit Hoti dhe presidentit serb Aleksandar Vuçiq. Takimi i korrikut u pasua nga një takim në shtator, por që nga ajo kohë palët nuk janë takuar më. Lidhur me mosmbajtjen e raundeve të reja të bisedimeve në nivelin e lartë politik, BE-ja është arsyetuar me situatën që ka të bëjë me pandeminë.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se dialogu për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë pritet të vazhdojë në Bruksel më 10 dhjetor, në takimin ndërmjet delegacioneve shtetërore të Kosovës dhe Serbisë. Në një konferencë për media ai ka thënë se pret që ky proces të përmbyllet brenda disa muajsh. Sipas tij, një marrëveshje e mundshme përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet ta përfshijë njohjen reciproke. “Atë që e kam thënë vazhdimisht, e them edhe sot, ky është një proces i kufizuar në kohë dhe është çështje muajsh. Besoj se për disa muaj

vijmë në fund të këtij procesi. Unë do të doja që në fund të vijmë me marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke ose do të konkludojmë se nuk mund të merremi vesh për marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke”, ka thënë Hoti. Takimi i së enjtes në Bruksel do të zhvillohet në nivel të ekspertëve, ku ekipi nga Kosova do të udhëhiqet nga koordinatori shtetëror për këtë proces, Skender Hyseni.

Ky proces do të vazhdojë pavarësisht kërkesës së vazhdueshme të AAK-së, partisë së dytë më të madhe në koalicionin qeverisës, që procesi të pezullohet përkohësisht për shkak të aktakuzave të para të Gjykatës Speciale. Madje kërkesën për ndërprerje të



Engeli kërkon nga Gjykata Speciale t'i hetojë edhe krimet e Serbisë të kryera në Kosovë

WASHINGTON, 8 DHJETOR - Kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme në Kongresin e ShBA-së, Eliot Engel, ka kërkuar nga Gjykata Speciale t'i hetojë krimet e Serbisë të kryera në Kosovë. Engeli ka thënë se bashkësia ndërkombëtare e ka shtyrë Kosovën që ta themelojë Gjykatën Speciale dhe jo Serbinë e cila ka kryer krime në krye me Slllobodan Millosheviqin. "Thërras Serbinë që t'u bashkohet vendeve të tjera në BE. Më 1999 ndalëm gjenocidin në Evropë dhe ky është një veprim për të cilin duhet qenë krenar. Më 1999 vriteshin njerëzit. Ende ka trupa të shqiptarëve në Serbi, në mesin e tyre edhe tre vëllezër shqiptaro-amerikanë. Bashkësia ndërkombëtare ka shtyrë Kosovën që të ngrehë Gjykatë Speciale, e jo Serbinë e cila ka kryer krime në krye me Slllobodan Millosheviqin", ka thënë Engeli në seancën dëgjimore për Ballkanin

Perëndimor dhe udhëzimet e administratës së re të ShBA-së. Kongresisti Engel ka thënë se Kosovë është shtyrë nga bashkësia ndërkombëtare të themelojë gjykatë hibride. "Secili që ka kryer krime duhet të ndiqet dhe të sillet para drejtësisë. Por çka është drejtësi në rastin e luftës në Kosovë? Serbia është përgjegjëse për shumicën e krimeve që janë kryer në Kosovë. Kosova është shtyrë që të krijojë gjykatë hibride", ka thënë Engeli, duke shtuar se Serbia nuk mund të ulet në dy karrige në të njëjtën kohë. "Edhe nëse Kosova ka kryer krime duhet të mbahet përgjegjëse, por ShBA-ja dhe aleatët tanë nuk duhet ta lejojnë këtë që të jetë gjykatë njëtnike. S'ka rëndësi kush i ka kryer krimet, por të gjitha ato duhet të hetohen. Serbia nuk mund të ulet në dy karrige në të njëjtën kohë", ka thënë Engeli.

Më tutje, ai ka thënë se Kosova është shtet i pavarur dhe se Serbia duhet të lëvizë drejt



njohjes së Kosovës. "Kosova është vend i pavarur për mbi një dekadë. Kosova i është bashkuar

Bankës Botërore dhe FMN-së dhe njihet nga shumë vende të njohura. Është Serbia që duhet të

lëvizë. Kosova është e pavarur. Kjo [punë] nuk zhbëhet", ka deklaruar Engeli.

Ish të burgosurit e vlerësojnë nismë të duhur shndërrimin e ish-burgut të Prishtinës në muze

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Ministrija e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, bashkë me një grup të ish të burgosurve politikë, në krye me Fetah Berishën, kanë vizituar të martën ish-burgun e Prishtinës. Ministrija Dumoshi i njoftoi ish të burgosurit për planet që ka MKRS-ja për shndërrimin e ish-burgut të Prishtinës në muze për ta dokumentuar të kaluarën e rëndë që ka kaluar populli

shqiptar i Kosovës si pasojë e trysnisë dhe dhunës së sistemit të kryesuar nga regjimi monist i kohës e më pas. Ministrija e informoi Berishën dhe ish të burgosurit se ka themeluar grupin punues që do ta konceptojë objektin e ish-burgut për ta shndërruar në muze. Dumoshi ka thënë se do të grumbullohet i tërë dokumentacioni ekzistues dhe i mundshëm, rrëfimet e të burgosurve, të dhëna të tjera materiale dhe do të realizohen

brenda objektit disa ndërhyrje, për ta kthyer burgun në formën origjinale. "Është obligim dhe detyrim i institucioneve të Kosovës që t'i dokumentojnë vuajtjet, përjetimet dhe tmerret që kanë kaluar gjeneratat e mëparshme për të ardhur deri sot kur ne kemi shtetin dhe institucionet tona", ka thënë ministrija Dumoshi. Ish i burgosuri Fetah Berisha e falënderoi ministren Dumoshi për këtë nismë dhe u shpreh se në këto ambiente ku po qëndron

bashkë me shokë kanë përjetuar tmerre të paimagjinueshme. "Prej ditës së burgosjes, më 22 korrik 1981, natën e parë më kanë dërguar në kufi me Shqipërinë, ku policë të asaj kohe më kanë shkreh në dru, më pas më kanë sjellë në burgun e Prishtinës dhe më kanë mbajtur 6 muaj për t'i zhvilluar hetimet derisa janë kryer ato dhe Gjykata e atëhershme e Qarkut e Prishtinës më pati dënuar me dy vjet burgim", ka rrëfyer ish i burgosuri rahovecas, Fetah Berisha.

Berisha dhe të burgosurit e tjerë vizituan qelitë dhe pavijonet e ish-burgut dhe sollën në kujtesë tmerret që kanë përjetuar aty dhe vlerësuan se është një veprim shumë i duhur dhe i pritur nisma për ta shndërruar ish-burgun e Prishtinës në muze. "Është mirë që gjeneratat që vijnë pas të dinë se çfarë ka përjetuar populli shqiptar i Kosovës për të ardhur deri te liria", u shprehën ish të burgosurit, të cilët edhe e falënderuan ministren Dumoshi për këtë projekt.



Kosova dhe Suedia diskutojnë për reformat kryesore të zhvillimit

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Zyra e kryeministrit dhe Ambasada e Suedisë në Kosovë organizuan takim vjetor midis Suedisë dhe Kosovës në kuadër të bashkëpunimit suedez për reforma me Kosovën si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit për reforma gjatë periudhës 2014-2020.

Në hapje të takimit, zëvendëskryeministri Driton Selmanaj ka theksuar angazhimin e qeverisë për një dialog të hapur me partnerët zhvillimorë, në mënyrë që t'i harmonizojnë përpjekjet e tyre së bashku dhe ta përqendrojnë të gjithë mbështetjen e jashtme drejt agjendës zhvillimore të

Kosovës.

Selmanaj theksoi se në periudhën afatshkurtër fokusi kryesor i qeverisë është që ta menaxhojë situatën me pandeminë Covid-19 dhe ta sigurojë zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social. "Është e rëndësishme për qeverinë që mbështetja suedeze të jetë plotësisht e koordinuar me mbështetjen që marrim nga vendet dhe organizatat e tjera, andaj ne synojmë t'i shtojmë përpjekjet tona për ta forcuar sistemin e koordinimit të donatorëve përmes funksionimit të plotë të strukturave të krijuara për këtë qëllim", ka thënë Selmanaj.



Ambasadorja e Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck, ka përshëndetur angazhimin e qeverisë për ta përmirësuar sistemin e koordinimit të

donatorëve, pasi ky është një shqetësim që Suedia ka ngritur në raste të mëparshme. Suedia aktualisht është duke përgatitur një strategji të re për

bashkëpunimin, që do të vazhdojë të përqendrohet në barazinë gjinore, mjedisin dhe klimën, zgjidhjen pas konfliktit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Gjatë takimit delegacionet e udhëhequra nga zëvendëskryeministri Selmanaj dhe ambasadorja Hernmarck shqyrtuan progresin për zbatimin e ndihmës së Suedisë për periudhën 2014-2020 në vlerë prej 8-10 milionë eurosh në vit.

Delegacionet konfirmuan se ndihma po zbatohet siç është planifikuar, momentalisht me programe dhe projekte të ndryshme.

Nënshkruhet marrëveshja për angazhimin e studentëve në praktikë profesionale



PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë me rektorin e Universitetit të Prishtinës

"Hasan Prishtina", Naser Sahiti, me qëllim të ofrimit të mundësive më të mëdha për studentët edhe në këtë kohë pandemie, të martën kanë

nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila ua mundëson studentëve të Fakultetit Filozofik, Departamentit të Punës

Sociale, realizimin e programit të praktikës në punë gjatë studimeve të tyre, përmes angazhimit në Qendrat për Punë Sociale (QPS), si dhe në

qendrat rezidenciale për të moshuarit dhe qendrat rezidenciale të aftësisë së kufizuar, që funksionojnë nëpër komunat e Kosovës.

Kjo marrëveshje në mes MPMS-së dhe UP-së parasheh për një vit angazhim në praktikë në punë nga 80 deri 100 studentë të diplomuar në Departamentin e Punës Sociale dhe në disa drejtime të tjera që kanë kualifikimin adekuat për ofrimin e shërbimeve sociale.

Këta studentë në kuadër të kësaj marrëveshje do të kenë mundësi t'i përmbushin edhe kriteret për t'u licencuar si ofrues individualë të shërbimeve sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. "Si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale jam i përkushtuar që me programe si ky të vazhdojmë edhe në të ardhmen, me qëllim të angazhimit të studentëve, të papunëve si dhe personave të pakualifikuar në masa aktive të tregut, duke u mundësuar praktikë në punë, aftësim dhe trajnime profesionale, grante për biznese të vogla vetjake etj", ka thënë ministri Reçica.

Aktakuzë personit që kërcënoi ambasadorin Gashi

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit F. M. për shkak të veprës penale: shtytje për kryerje të veprave terroriste. Aktakuza u ngrit në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Në njoftimin e Prokurorisë thuhet se i pandehuri më 19

tetor të këtij viti ka postuar në rrjetin social "Facebook" thirrje me përmbajtje kërcënuese kundër ambasadorit të Kosovës në Francë, Qëndrim Gashi.

Thirrja për "vrasjen" e Gashit ka qenë "me paramendim dhe dashje", ka njoftuar Prokuroria. Sipas saj, ajo është bërë pasi ambasadori Gashi ka postuar

në "Twitter" një karikaturë të Profetit Muhamed, si shenjë reagimi ndaj vrasjes së një mësuesi në Francë. "Me këto veprime, i pandehuri F. M. ka kryer veprën penale 'shtytje për kryerjen e veprave terroriste' nga neni 134 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës.



Hoti fton viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës të aplikojnë për njohje të statusit



Kryeministri Avdullah Hoti ka shprehur mbështetje ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ai gjatë një diskutimi mbi procesin dhe sfidat e njohjes së statusit të këtyre viktimave, kryeministri Hoti ka inkurajuar të gjithë personat që kanë qenë viktimat të këtij krimi të tmerrshëm të luftës, që të aplikojnë për ta fituar statusin që u takon. Ndërkaq ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, duke folur për rëndësinë e trajtimit të kësaj çështje, ka thënë se me viktimat e dhunës seksuale nuk duhet bërë politikë, por që ky proces duhet të trajtohet me përgjegjësi institucionale e shoqërore

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, të martën është mbajtur konferenca me temën: "Progresi dhe sfidat e procesit të njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë". "Qeveria e Republikës së Kosovës është plotësisht e përkushtuar që procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë ta mbështesë, në mënyrë që viktimat ta ndiejnë mbështetjen e shtetit të tyre", ka thënë kryeministri Hoti.

Ai i ka inkurajuar të gjithë personat që kanë qenë viktimat të

këtij krimi të tmerrshëm të luftës, që të aplikojnë për ta fituar statusin që u takon. Në të njëjtën kohë i bëri thirrje gjithë shoqërisë që të mbështesë këtë proces, sepse turpi bie mbi kryesit e këtij krimi e jo mbi viktimat. Kurse ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se të mbijetuarit e dhunës seksuale ende po përballen me probleme të mëdha. Ajo ka theksuar se të gjitha institucionet dhe shoqëria në përgjithësi duhet të angazhohen më shumë që të mbijetuarve të dhunës t'u kthehet besimi dhe inkuadrimi në shoqëri. "E dimë se të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë po përballen me probleme të shumta, duke u nisur nga pasiguria që ata i rrethon në

shoqëri. Mungesa e mbështetjes së familjes dhe frika se mund të gjykohen prapë nga komuniteti në përgjithësi dhe nga rrethi i tyre për krimin që ata dhe ato kanë përjetuar dhe për krimin që është kryer padrejtësisht ndaj trupit të tyre", ka thënë Jahjaga. Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, në fjalën e tij para të pranishmëve ka folur për rëndësinë që ka procesi i njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, sfidat dhe rëndësinë e bashkëpunimit institucional me përgjegjësinë që të mbijetuarat të trajtohen me respekt dhe dinjitet. Selimi ka thënë se ministria të cilën ai e drejton mbetet e përkushtuar për përbushjen e të gjitha obligimeve për t'i ofruar kësaj

fillimisht kategori infrastrukturën e duhur ligjore dhe qasjen në drejtësi. Ministri Selimi ka theksuar se bashkërisht me aktorët relevantë janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm duke përgatitur planin e veprimit për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës i cili identifikon pengesat që të mbijetuarat i kanë për të pasur këtë qasje. Ministri Selimi, duke folur për rëndësinë e trajtimit të kësaj çështje, ka thënë se me viktimat e dhunës seksuale nuk duhet bërë politikë, por ky proces duhet të trajtohet me përgjegjësi institucionale e shoqërore në bazë të veçorive dhe nevojave që ka kjo kategori e shoqërisë.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se kjo është një konferencë me një temë tejet të dhimbshme për Kosovën, pra për historinë më të re të saj dhe në një kohë të veçantë për qytetarët tanë. "Sot, në kohën kur ne po diskutojmë për trajtimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, fatkeqësisht shkaktarët e kësaj dhune gjenden ende të lirë dhe të padënuar, tani e 20 vjet, madje në vend të kërkimfaljes ata sot, nisur nga mendësia e vjetër e tyre dhe prej së cilës nuk po arrijnë të zhveshën, vazhdojnë kërcënimet, duke e luftuar çdo ditë politikisht Kosovën", ka thënë ministri Reçica.

Ai gjithashtu tha se sjellja e përgjegjëse të kësaj dhune duhet të na shërbejë neve dhe drejtësisë ndërkombëtare, se kryesitë e vërtetë të krimeve në Kosovë, dhunuesit që shkaktuan këto plagë, të vihen para drejtësisë dhe që sadopak të mbijetuarat e kësaj dhune të kenë satisfaksion.

Në vitin 2014 Kuvendi i Kosovës kishte miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore në mënyrë që personave që përjetuan këto krime gjatë luftës t'u njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale, me çka u është mundësuar ta marrin pensionin ligjor që arrin në vlerën rreth 230 euro në muaj. Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë deri tash ka pranuar 1 361 aplikacione për pension. Deri tash, sipas këtij komisioni, marrin pagë mujore 894 persona. Nga ky numër, 31 janë burra të cilët kanë përfituar këtë pension nga shteti. Bazuar në deklaratat e zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, gjatë luftës së fundit kanë ndodhur rreth 20 mijë raste të abuzimit seksual.

Osmani kërkon që Shqipëria ta mbështetë Kosovën në mekanizmat rajonalë

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën një delegacion të Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga kryetarja Mimi Kodheli, njëherësh zëvendës-presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Të dyja palët diskutuan për bashkëpunimin ndërparlamentar ndërmjet të dy vendeve dhe u angazhuan që të rritet bashkëpunimi.

Gjithashtu, u diskutua edhe mundësia e mbështetjes ndaj Kosovës e shtetit shqiptar në nismat rajonale apo edhe në raport me Aleancën Veri-Atlantike.

Kryetarja Osmani ka thënë se është i nevojshëm koordinimi ndërshtetëror për ta mbështetur Kosovën në mekanizmat rajonalë e më gjerë ku duhet ta ketë zërin, porse nuk e ka të drejtën e përfaqësimit. Në këtë kontekst, ka marrë mbështetjen e palës shqiptare dhe premtimin për një pajtim të veprimeve në hapat e mëtejme.



'Trepça' blen eksploziv në vlerë gjysmë milioni euro

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Ndërmarrja Publike "Trepça" do të ndajë gjysmë milioni euro për t'u furnizuar me eksploziv. Përmes njoftimit për dhënie të kontratës të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, "Trepça" ka bërë me dije se eksplozivi po i nevojitet për Minierën e Stantërgut. Vlera e përgjithshme e kontratës është 519 mijë e 650 euro, derisa kohëzgjatja e kontratës është për 12 muaj. Për këtë tender ishin pranuar ofertat e dy kompanive, por që në fund fituese është shpallur

kompania "Ex Projekt". Kontrata është dhënë më 7 dhjetor, kurse nënshkrimi i saj është planifikuar të bëhet më 11 dhjetor të këtij viti. "Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në nenin i të këtij njoftimi për dhënie të kontratës", thuhet në njoftimin e publikuar në KRPP.



Mustafa premtion përkrahje për kultivimin e mjedrës në Kosovë



PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Shoqatës "Mjedra e Kosovës", kryetarin Sami Uka dhe drejtorin ekzekutiv Kujtim Lepaja. Përfaqësuesit e Shoqatës së Mjadrës folën mbi sfidat e kultivuesve si dhe përcollën reagimet e komunitetit, mes të

cilave atë për pagesën e subvencioneve për këtë kulturë. Nga ana tjetër, ministri Mustafa, pasi dëgjoi me vëmendje të gjitha vërejtjet, tha se ka për ta vazhduar përkrahjen e ministrisë ndaj kultivuesve të mjedrës. Ministri Mustafa ua rikujtoi përfaqësuesve të kultivuesve të mjedrës se pagesa e subvencioneve për këtë kulturë

po vijon. "Pas ekzekutimit të pagesës së parë do të vijohet me ciklin e dytë të pagesës, i cili po zbatohet si pjesë e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike", ka deklaruar Mustafa. Ministri Mustafa ka theksuar gjatë takimit se do të vazhdojë t'u qëndrojë pranë kultivuesve të mjedrës për tejkalimin e sfidave të cilat mund të shfaqen në këtë sektor edhe në të ardhmen.

Ministria e Infrastrukturës: Mirëmbajtja e rrugëve vazhdon 24 orë në tërë vendin



PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka dhënë detaje për gjendjen ditore të rrugëve kombëtare dhe rajonale. Sipas kësaj ministrie, në disa akse rrugore është hedhur kripë për shkak të ngricave, ndërsa reshje nuk ka pasur në asnjë aks rrugor. "Mirëmbajtja e rrugëve vazhdon 24 orë në tërë Republikën e Kosovës. Në auto-udha R6, Doganaj-Hani i Elezit, gjatë 24 orëve nuk ka pasur reshje të borës dhe të gjitha rrugët janë të kalueshme. Borë nuk ka pasur as në auto-udhën A7, Morinë-Gjurgjicë", thuhet

në njoftimin e MI-së. Në regionin Prishtina 1 dhe 2, sipas MI-së, gjendja e rrugëve është e mirë, pa të reshura të borës gjatë 24 orëve të fundit. Kurse në regionin e Prizrenit, të gjitha rrugët nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës janë të qarkullueshme dhe nuk ka pasur të reshura të borës. Po ashtu, në regionin Peja 1 dhe 2 të gjitha rrugët janë të kalueshme dhe s'ka pasur reshje të borës gjatë 24 orëve. Në regionin e Ferizajt ka pasur hedhje të kripës për shkak të ngricave, por pa të reshura bore.

ATK-ja: Paguaj tatimin bazë, përfito nga shlyerja e interesit

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, tatimpaguesit që kanë obligime të paguara ndaj ATK-së mund të përfitojnë nga falja e interesit. "Të gjithë

personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë obligime tatimore të paguara ndaj ATK-së për periudhat janar/2020 deri dhjetor/2020, mund të përfitojnë nga falja e interesit, me kusht që të njëjtët, për periudhat e lartcekura, ta kryejnë pagesën e plotë të tatimit

bazë (kryegjësë) deri më 31 dhjetor 2020. Vetëm tatimpaguesit të cilët shfrytëzojnë këtë mundësi dhe përmbushin detyrimin e kërkuar brenda periudhës ligjore deri me 31 dhjetor 2020, do të përfitojnë nga falja e interesit", ka njoftuar Administrata Tatimore e Kosovës.



Nga e premtja qytetarët mund të aplikojnë për tërheqjen e kursimeve të tyre pensionale

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka takuar të martën përfaqësuesit e BQK-së dhe të Trustit të Kursimeve Pensionale, ku për temë diskutimi kishin përgatitjet lidhur me zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike. Pas takimit, kryeministri Hoti ka mbajtur një konferencë për media, ku ka bërë me dije se nga e premtja qytetarët mund të aplikojnë për tërheqjen e kursimeve të tyre pensionale. Po ashtu, ai ka theksuar se kanë biseduar që Banka Qendrore të komunikojë me Fondin për Garantim të Kredive përmes Ministrisë së Financave, në mënyrë që sa më parë të fillojë zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje edhe në pjesën

që lidhet me garantimin e kredive për bizneset.

Kryeministri Hoti nënvizoi se qeveria do t'i marrë përsipër të gjitha obligimet që parashihen me ligj. "Është përgatitur edhe sistemi, është hapur uebfaqja dhe të premtën në orën 15:00 pasdite hapet sistemi për qytetarë për të aplikuar për tërheqjen e këtyre kursimeve. Besoj se sistemi, në bazë të përgatitjeve që janë bërë, është plotësisht i sigurt dhe është i përgatitur ashtu që të përballojë fluksin, çfarëdo fluksi që mund të ketë nga ana e qytetarëve për tërheqje të këtyre mjeteve. Më vjen mirë që kemi ardhur deri në këtë pikë, në veçanti tash në festat e fundvitit me këtë pandemi, ku plot familje, plot qytetarë ta kenë buxhetin minimal për familjet e tyre dhe që t'i ndikojnë sigurisht ekonomisë. Dhe e dyta, gjithashtu biseduam që



Banka Qendrore të komunikojë me Fondin për Garantim të Kredive përmes

Ministrisë së Financave që sa më parë të fillojë zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje në

pjesën që lidhet me garantimin e kredive", ka thënë Hoti.

Forumi i Davosit bartet në Singapor më 2021



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Organizatorët e Forumit Ekonomik Botëror ka njoftuar se pandemia e koronavirusit, i ka shtyrë që ta bartin samitin e vitit të ardhshëm nga Zvicra në Singapor, i cili do të mbahet me prani fizike nga 13-16 maj. Organizimi vjetor i elitës politike, ekonomike dhe biznesore në botë, zakonisht zë vend në janar, në fshatin zviceran Davos. Mirëpo ky organizim është shtyrë deri në muajin maj, për shkak të pandemisë së koronavirusit dhe organizatorët kanë thënë se fokusi do të jetë në rimodelim të ekonomisë

botërore pas krizës së shkaktuar nga pandemia, transmeton agjencia e lajmeve, AFP.

Fillimisht ishte planifikuar që forumi të zhvillohej në një tjetër qytet zviceran, mirëpo situata me pandeminë ka shtyrë organizatorët ta bartin ngjarjen në një shtet krejt tjetër. "Ndryshimi i lokacionit reflekton prioritetet e forumit për ruajtje të shëndetit dhe siguri të pjesëmarrësve", është thënë në një deklaratë. Singapori është shpallur vendi më i përshtatshëm për këtë takim. Forumi Ekonomik Botëror është thënë se do t'i kthehet Davosit në vitin 2022.

Gastronomët kërkojnë që të mos kufizohet puna gjatë festave

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka reaguar pas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike nga pandemia Covid-19. Gastronomët në këtë reagim kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që të mos ketë kufizim të punës gjatë festave të fundvitit. "Lusim

Qeverinë e Kosovës të na lejojë të punojmë. Jemi pranë festave dhe qytetarëve të Kosovës, po ashtu edhe diasporës duam t'u qëndrojmë më afër në kohë më të gjatë pune dhe sadopak ta përmbyllim së bashku një vit të brishtë, duke u mundësuar kështu edhe bizneseve të

mbijetojnë. Është mundësia jonë e fundit që sadopak të mbesim në këmbë këtë vit. Me tri lule nuk çel pranvera! Nëse qëndron ideja të lirohen masat vetëm për tri net të Vitit të Ri, atëherë për ne si gastronom mos e bëni fare", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.



Komuna e Gjilanit bashkë me FSK-në pastrojnë ambientin dhe mbjellin drunj te penda e Livoqit



GJILAN, 8 DHJETOR (ER) - Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Regjimentin e Parë të Forcave Tokësore të FSK-së dhe Agjencinë për Zhvillim Rajonal Lindje, kanë bërë pastrimin e ambientit dhe kanë mbjellë drunj dekorativë përkaj pëndës së Livoqit.

Nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos i hedhin mbeturinat. Ai ka siguruar se


qytetarët që aty ku ka mundësi, Komuna e Gjilanit do të ndërhyjë për ta pastruar çdo pjesë ku ka mbeturina. "Falë përkushtimit të Forcave të Armatosura të Kosovës ne e pastruam pëndën e Livoqit dhe mbollëm drunj dekorativë. Ky aksion është simbolik dhe nuk është as i pari dhe besoj nuk do të jetë as i fundit që FSK-ja do të na bashkëngjitet. Në emër të kryetarit Haziri e falënderoj FSK-në që është gjithmonë

me ne", ka thënë Ismajli. Zëvendëskomandanti i Regjimentit të Parë i Forcave Tokësore të FSK-së, major Kadri Berisha, ka thënë se do t'u dalin në ndihmë institucioneve sa herë që kërkojnë. Në emër të Agjencisë për Zhvillim Rajonal Lindje ka folur drejtori ekzekutiv, Agim Zeka, i cili i ka falënderuar komunën dhe FSK-në për pastrimin e ambientit aty dhe mbjelljen e drunjve.

Bulliqi viziton QKMF-në në Podujevë, premtion përkrahje për stafin shëndetësor

PODUJEVË, 8 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar të martën Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Podujevë.

Gjatë kësaj vizite kryetari Bulliqi është njoftuar nga menaxhmenti i QKMF-së për punët dhe për angazhimet e tyre të përditshme, për nevojat dhe sfidat me të cilat ata përballen gjatë punës së tyre në shërbim të qytetarëve. Bulliqi ka premtuar përkrahje dhe angazhim maksimal të ekzekutivit komunal për QKMF-në, duke pasur parasysh gjendjen e saj, sidomos gjatë kohës së përbaljes me pandeminë Covid-19. "Do të jem në vizita të shpeshta në QKMF për t'i parë nevojat dhe për t'i bërë



intervencimet e nevojshme që ndikojnë në plotësimin e nevojave për punë dhe për shërbime cilësore ndaj qytetarëve llapjanë", ka thënë Bulliqi.

Kryetari Bulliqi vizitoi edhe shërbimin emergjent dhe qendrën e triazhimit për

Covid-19. Nga ekipi mjekësor në këtë repart, kryetari Bulliqi u njoftua me situatën epidemiologjike dhe procesin e testimit për Covid-19. Bulliqi ka falënderuar ekipin mjekësor për angazhimin në këtë situatë të vështirë pandemike.

Kryetari i Lipjanit viziton pacientët me Covid-19

LIPJAN, 8 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në këtë komunë, në të cilën është duke u bërë furnizimi me inventar të ri dhe pajisje të tjera të nevojshme për stafin mjekësor.

Kryetari Ahmeti, po ashtu, ka vizituar edhe hapësirat të cilat janë dedikuar për Covid-19, ku po trajtohen pacientët me Covid-19. Pacientë u shprehën shumë mirënjohës ndaj stafit mjekësor në Lipjan dhe angazhimet e Komunës së Lipjanit në këtë pandemi.



Ilazi: Viti 2020, vit i kompletimit të infrastrukturës rrugore

Kaçanik, 8 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, me bashkëpunëtorë komunalë, ka vizituar nga afër punimet përfundimtare që po realizohen në projektin "Ndërtimi i trotuarit në lagjen Topall - Soponicë". Kryetari Ilazi ka thënë se projekte të tilla po

mundësojnë krijimin e kushteve më të sigurta për këmbësorë, sidomos për fëmijë që kalojnë në këtë pjesë për vijim të shkollës. Ai ka thënë se viti 2020 është vit i kompletimit të infrastrukturës rrugore edhe me trotuare. Trotuari në lagjen Topalli - Soponicë ka një gjatësi 870 metra. Kostoja e

projektit është 22,767.53 euro.

Krahas punimit të trotuarit janë duke u punuar edhe bazamentet e ndriçimit publik. Këtë vit janë investuar mijëra euro për rregullimin e trotuareve në hapësira të frekuentuara e në zona që kanë paraqitur rrezik për këmbësorë.



Fillon ndërtimi i ujësjellësit për njëmbëdhjetë fshatra të Klinës



KLINË, 8 DHJETOR (ER) - Në Komunën e Klinës kanë filluar punimet për ndërtimin e ujësjellësit për njëmbëdhjetë fshatra, projekt ky me një vlerë prej 1 484 993 eurosh dhe i financuar nga Qeveria e

Zvicrës, e cila ka mandatur organizatën CDI për implementimin e këtij projekti, pas kërkesës nga komuna.

Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga

nënkryetari Besim Hoti, drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Iber Elezaj, Astrit Vokshi, përfaqësues i CDI-së në Kosovë, kanë marrë pjesë në përrurimin e punimeve për realizimin e

këtij projekti. Fshatrat në të cilat do të ndërtohet apo rehabilitohet rrjeti i ujësjellësit janë: Caravik, Çabiq, Zabergjë, Ujmirë, Doberdol, Rixhevë, Stapanicë, Gllarevë, Përqevë, Gjurgjevik i Madh dhe Stupë.

Ndërmjetësuesi që nuk ulet në mes



Nga Valmir ELEZI

Bill Clintoni së bashku me dy mysafirët e tij kryesorë, Yitzhak Rabin dhe Yasser Arafat, po pritshin me shumë entuziazëm nga mysafirët e tjerë të zgjedhur të dilnin në lëndinën e Shtëpisë së Bardhë. Dera është e ngushtë dhe nuk i zë të dalin përnjëherë. Clintoni, që duket se qëndron vazhdimisht në mes, bën një hap përpara dhe pret derisa izraeliti e palestinezi t'i bashkohen dhe së bashku të ngjiten në foltoren e improvizuar. Atë të hënë të 13 shtatorit 1993, Clintoni tregohet shumë i kujdesshëm në këtë parakalim historik, që i bën bashkë dy njerëz të dy vendeve me një histori të pafund luftërash dhe përpjekjesh për paqe, por që asnjëherë nuk arrijnë të qetësojnë Lindjen e Mesme. Aty u nënshkrua "Deklarata e Parimeve", që shihet si një risi në këtë konflikt prej më të gjatëve në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare por që, fatkeqësisht, ky proces paqeje u ndërpre më vonë.

Profesori emeritus i marrëdhënieve ndërkombëtare në Oksford, Avi Shlaim, do të shkruante më vonë se: "Asgjë nuk ishte më njësoj në botën arabe si rrjedhojë e marrëveshjes midis Izraelit dhe OÇP-së. Rregullat e lojës në të gjithë Lindjen e Mesme kishin ndryshuar në mënyrë rrënjësore". Ai përmend edhe rastin kur Jordania i kishte dhënë leje një televizionit izraelit transmetimin e parë të drejtpërdrejtë televiziv nga një prej korrespondentëve të tij prej Amanit. Natyrisht se kjo nuk është një përpjekje për të tërhequr paralele mes raporteve të dy vendeve tona, Kosovës dhe Serbisë, por një paraqitje e kompleksitetit të këtij konflikti dhe rolin e kujdesshëm të Amerikës në procesin e paqes, nga e cila mund të mësohet. Ekziston një pajtueshmëri e gjithëmbarshme se negociatat janë rruga më e mirë për t'i zgjidhur problemet. Mes disa llojeve të negociatave, e që nuk janë të shumta, vetëm një duket se ka qenë e mundur të zhvillohet mes Kosovës dhe Serbisë: Negociatat me mediatorë apo ndërmjetësues. Për shkak të historisë Kosova dhe Serbia e kanë të pamundur që të zhvillojnë negociata të drejtpërdrejta. Mes shumë arsyeve Serbia nuk është dënuar

akoma për krimet e kryera në Kosovë. Prandaj, është e pamundur që të ulen në një tryezë të dyja palët: Kosova dhe Serbia, pa praninë e një pale ndërmjetësuese. Të gjitha elementet që kërkohen për negociata të drejtpërdrejta mungojnë këtu. Të njohur me situatën, kjo ka qenë arsyeja që BE-ja u caktua si lehtësuese e dialogut Kosovë - Serbi nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, e cila miratoi rezolutën të sponsorizuar nga 27 vendet e BE-së dhe Serbia. Njëkohësisht, kjo është koha kur dialogu bëhet detyrim ndërkombëtar për të dyja vendet, i cili nisi si teknik për të amortizuar reagimin, por që shpejt u shndërrua në atë që ishte menduar nga fillimi: dialog politik. Në negociatat e tilla që lehtësohen nga një palë e tretë, mediatori duhet të qëndrojë gjithmonë neutral. Por, ka edhe një detaj që negociatat i bën të mos duken si një veprimtari e zakonshme: Mediatori duhet të qëndrojë mes palëve edhe fizikisht dhe jo vetëm në qëndrime e propozime. Kosova dhe Serbia janë në fazën përfundimtare të dialogut gati njëdekadësh, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Për ta treguar seriozitetin e vet, BE-ja ka caktuar si emisar të posaçëm për

dialogun, sllovakun Miroslav Lajçak. Ndonëse si një mediator është i thirrur për të qëndruar në mes, Lajçaku bëri një gabim që pikërisht në negociata nuk mund të ndodhë. Në korrikun e nxehtë të 2020-s, delegacioni i Kosovës dhe Serbisë po qëndronin ballë për ballë në tavolinë të ftuar nga shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell. Palët u kthyen në tavolinën e negociatave gati dy vjet pas ndërprerjes së dialogut, por në mes të tyre nuk ishte edhe i emëruari i posaçëm, Lajçak. Ai qëndronte në krah të presidentit të Serbisë, Vuçiq. Ky gjest i tij nuk mund të kalohet pavërejtshëm. Pozicionimi i tij bëhet edhe më i fuqishëm nga kërkesat e veçanta të cilat ia humbin neutralitetin. Vetëm disa javë pas takimit që rinisi dialogun, Lajçaku vizitoi Prishtinën dhe Beogradin. Deri atëkohë nuk ishte thënë aq hapur në publik se çfarë duhet të bëjnë palët për të arritur marrëveshje: Kosova dhe Serbia, secila prej tyre, duhet të ndryshojë Kushtetutën e vet. Pra, Serbia duhet ta ndryshojë Kushtetutën, pasi e parasheh Kosovën si pjesë përbërëse të territorit të saj dhe Kosova përmes ndryshimit të Kushtetutës duhet të mundësojë hapësirë për Asociacionin. Kjo kërkesë e shprehur drejtpërdrejt, që në vlerësim të parë duket si e balancuar sepse po u kërkohet dy palëve të bëjnë të njëjtin

ndryshim: t'i ndryshojnë kushtetutat e tyre, nuk është në fakt një kërkesë e balancuar. Ky është një pozicionim i qartë i ndërmjetësuesit. Kosova nuk është përgjegjëse pse Serbia mban në Kushtetutën e saj nënin problematik për paqen në rajon. Ky duhet të jetë një problem dhe peshë që rëndon mbi Bashkimin Evropian, të cilin duhet ta zgjidhë drejtpërdrejt me Serbinë dhe jo duke kërkuar kompromis nga Kosova, si mënyrë që shtetet përreth të bëhen më paqësore. Procesi i paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk duhet parë vetëm si një normalizim marrëdhëniesh mes tyre. Kompleksiteti i problemit është i shtrirë në pothuajse në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe përbën temën mbizotëruese mes shteteve, pa llogaritur këtu edhe rolin në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nuk ka dyshim se fati i një marrëveshjeje ndërmjet dy vendeve ndodhet edhe në duart e ndërmjetësuesit, e jo vetëm të palëve negociuese. Prandaj, si një mediator, Lajçak duhet t'i shfletojë mësimet nga diplomacia botërore dhe arti i negociatave, në të kundërtën marrëveshjen mund të mos e zë Kuvendi ynë.

***Autori ka mbaruar studimet Master për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës**

Reagim i KMDLNj-së

Konsensusi politik, i domosdoshëm për menaxhimin e situatës që është e rëndë!

Kosova, edhe para shpërthimit të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, nuk e kishte një gjendje të qëndrueshme, as ekonomike e as politike. Pandemia ka shkaktuar dridhje të fuqishme edhe te shtetet me një ekonomi të zhvilluar dhe konsoliduar që është edhe kushti kryesor për qëndrueshmëri politike, kurse në Kosovë ekonominë, sidomos sektorin privat e ka vënë buzë greminës së falimentimit duke humbur me dhjetëra mijëra vende të punës me tendencë të përkeqësimit, deri në falimentim të pashmangshëm. Situatën e kanë përkeqësuar ndërrimet e shpeshta të qeverive duke e shndërruar në një luftë të egër për pushtet, në dëm të shtetit. Pandemia që po zgjatë më shumë se është menduar dhe që po i përmbys kapacitetet shëndetësore dhe ekonomike të Kosovës, në mungesë të një konsensusi politik po shkakton probleme dhe efekte zinxhirore, pasojat e të cilave po vërehen tani, kurse do të dalin në sipërfaqe në përmasa shqetësuese pas përfundimit të pandemisë. Të

gjitha vendet në botë e që janë prekur nga pandemia janë mobilizuar që sa më lehtë ta përballojnë këtë gjendje duke ua lehtësuar gjendjen qytetarëve që i përfaqësojnë. Ndërkaq, në Kosovë po ndodh e kundërta, në situata që janë të jashtëzakonshme, pavarësisht se zyrtarisht nuk e kemi këtë gjendje, po rrëzohet një qeveri (qeveria Kurti) kurse tani, qeveria e rrëzuar në kohë të pandemisë të gjitha forcat i ka mobilizuar ta rrëzojë qeverinë Hoti, gjithashtu në kohë të pandemisë përmes insistimit për zgjedhje të jashtëzakonshme! Kosova sot është para një kolapsi dhe ky është i pashmangshëm nëse nuk ndërtohet një unitet, mbase i përkohshëm, derisa të përfundojë pandemia e shkaktuar nga Covid-19. Kosova sot ka nevojë të ngutshme për një konsensus njerëzorë, politikë, kombëtar dhe moral nëse mendon ta tejkalojë situatën e krijuar. Të prodhosh kriza politike për interesa partiake dhe personale në kohën kur jemi në një krizë të përgjithshme, është mungesë e moralit elementar dhe



papërgjegjësi e skajshme. Të përpiqesh të marrësh apo ta mbash pushtetin në kohën kur as jetën nuk e kemi të sigurt është një veprim i pafalshëm. KMDLNj thërret të gjitha subjektet politike, institucionet përgjegjëse, personalitetet me autoritet, institucionet me autoritet moral si dhe atë joqeveritar që të ndërtojnë një konsensus për aq kohë sa zgjatë pandemia në mënyrë që të ndihmojnë qytetarët që kanë aq nevojë për një konsensus politik,

institucional, moral dhe kombëtar e që deri më tani ka munguar. Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 po merr, çdo ditë e më shumë jetë të njerëzve, sikur që numri i të prekurve po rritet në përmasa shqetësuese dhe nuk po bënë dallime as në baza kombëtare, bindjeve apo posteve politike, statusit në shoqëri, moshës, gjinisë dhe të tjera andaj duhet një mobilizim krejtësisht tjetër për luftimin e pandemisë, duke i lënë anash interesat partiake, politike, klanore dhe personale.

KMDLNj vlerëson se është momenti i fundit të veprohet mbi baza të një konsensusi të arritur, në dhe për interes të qytetarit, në të kundërtën, e tërë përgjegjësi do të adresohet te ata që nuk e duan këtë konsensus dhe interesin e përgjithshëm e thjeshtësojnë në interesa politike, partiake dhe personale në kohën kur kemi rrezikim masiv të shëndetit publik, ekonomik dhe sociale të cilat mund ta rrënojnë edhe vetë shtetin.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Fetahu edhe një mandat synon pozitën e kryetarit të FBK-së

Arben Fetahu ka vendosur t'i hyjë garës për kryetar të Federatës së Basketbollit për herë të dytë. Ai më 18 dhjetor do t'i shpalosë para delegatëve të Kuvendit të FBK-së programin dhe strategjinë zhvillimore për katërvjeçarin e ardhshëm dhe do ta kërkojë besimin e tyre. "Do të jem përjetë krenar me arritjet tona të përbashkëta në të cilat shumë dyshonin", ka thënë Fetahu



kontribuan për avancimin e basketbollit. Një nga sukseset më të madha që ka përmendur Fetahu ishte krijimi i Ligës Unike. "Dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Bordit të FBK-së, bashkëpunëtorët, stafin, sponsorët dhe përkrahësit për këto dy vjet e gjysmë bashkëpunim, punë, mund dhe

përkushtim, si dhe klubet e shoqatat e basketbollit për punën e palodhshme anembanë Kosovës për të mbajtur gjallë dhe avancuar basketbollin tonë. Do të jem përjetë krenar me arritjet tona të përbashkëta në të cilat shumë dyshonin. Na thanë se nuk mund të marrim organizimin e kampionateve evropiane e ne i

morëm tri. Na thanë se nuk mund të jemi pjesë e strukturave të FIBA-s e ne i morëm dy poste. Dhe ajo që është kryesorja, na thanë se nuk do na të lejohet nga armiqtë tanë krijimi i Ligës Unike, si liga e parë mbarëkombëtare, e ne e krijuam nën praninë e kryetarit të FIBA Europe", ka deklaruar Fetahu.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryetari aktual i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, ka konfirmuar se do të rikandidojë për kryetar të FBK-së edhe për një mandat tjetër. Pavarësisht prej mundësisë që kishte Fetahu për t'i shtyrë zgjedhjet për vitin tjetër, vendosi që të pranojë sfidën duke rikandiduar për mandatin e dytë në krye të basketbollit të Kosovës. "Pavarësisht prej mundësisë për t'i shtyrë zgjedhjet në Federatën e Basketbollit të Kosovës edhe një vit, unë vendosa që ato t'i shpallim këtë vit, në pajtim me statutin e Federatës dhe fjalën e

dhënë se mandati im do të përfundoj gjatë vitit 2020. Të hënën veç është konfirmuar, falë përkrahjes së anëtarëve të Federatës, se unë do të jem kandidat për kryetar të FBK-së për mandatin e ardhshëm olimpik. Prandaj, më 18 dhjetor 2020 do të shpalos para delegatëve të Kuvendit të FBK programin dhe strategjinë zhvillimore për katërvjeçarin e ardhshëm dhe do ta kërkoj besimin e tyre për ta shtyrë basketbollin e Kosovës drejt dimensioneve të reja", ka thënë Fetahu.

Fetahu ndihet krenar me punën që ka bërë në krye të FBK-së, kurse falënderoi të gjithë ata që

Peja arrin fitoren e gjashtë radhazi



PEJË, 8 DHJETOR - KB Peja ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 90:80 (28:23, 29:16, 20:23, 13:18) në kuadër të javës së gjashtë të Prince Caffè Superligës. Skuadra vendëse e nisi ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi deri në 11 pikë, megjithatë çereku i parë përfundoi 28:23. "Verdhezinjtë" nga Peja ishin edhe më bindës në periudhën e dytë (29:16), duke thelluar edhe më shumë epërsinë, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 57:39. Në periudhën e tretë u zhvillua lojë më e barabartë, madje mysafirët e fituan këtë pjesë 20:23, derisa

rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 77:62. Edhe në 10 minutat skuadra nga Theranda ishte më e mirë 13:18, por Peja në fund shënoi fitore 90:80. Te Peja u dalluan u dalluan Dardan Berisha me 29 pikë e tetë kërcime dhe Marko Peroviq me 22 pikë e tetë kërcime, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan Griffin Rame me 13 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime, Valon Bunjaku me 16 pikë e gjashtë kërcime, Samir Zekiqi me 15 pikë dhe Arbër Berisha me 12 pikë e gjashtë kërcime. Peja ka gjashtë fitore, kurse Golden Eagle Ylli katër fitore dhe dy humbje.

Çiftet e 1/16 së finales në Kupën e Kosovës

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Të martën në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës në praninë e anëtarit të KE-së, Xhelal Broja, Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për rrethin e 1/16 së finales së Kupës së Kosovës. Fillimisht të pranishmit në emër të presidentit Agim Ademi dhe KE

të FFK-së i përshëndeti Xhelal Broja, i cili u dëshiroi suksese klubeve në këtë rreth të garave, derisa më pas kryetari i KG-së, Avdyl Bellopoja, shpjegoi procedurat e tërheqjes së shortit, ku 10 klubet e Superligës dhe tri skuadrat e para të renditura në grupet respektive të Ligës së Parë u përfshin në një rreth vazo, derisa skuadrat e

ÇIFTET E 1/16 SË KUPËS
Besa-Istogu, Vushtrria-Drenica, Flamurtari-Drenasi, Prizreni-Feronikeli, Vitia-Ferizaj, Onix-Llapi, Ulpiana-Liria, Vëllaznimi-Trepça '89, FC A&N-Kika, Vllaznia Pozheran-Dukagjini, Drita-Trepça, Kosova VR-Prishtina, Gjilani-KEK-u, Ramiz Sadiku-Arbëria, Malisheva-2 Korriku, Dardana-Ballkani.

tjera në vazon tjetër. Ndeshjet për 1/16 e finales së Kupës së

Kosovës do të zhvillohen në mesjavën e ardhshme.



Dy federata sportive pranohen në KOK

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Federata e Golfit e Kosovës dhe Federata e E-sporteve janë pranuar në Komitetin Olimpik të Kosovës si anëtare të përkohshme. Vendimi për pranimin e këtyre dy federatave është marrë në

mbledhjen e 54-t të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut. Në këtë mbledhje, po ashtu, është vendosur që si pasojë e vështirësive financiare të krijuara nga pandemia Covid-19, KOK-u t'i mbështesë Federatat Sportive

të Kosovës nga fondi i rimëkëmbjes i fituar nga Komiteti Olimpik i Evropës (KOE) dhe Asociacioni i Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC). Gjithashtu u miratua rekomandimi për shpërblime i

Federatës së Xhudos së Kosovës për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pas rezultateve të arritura në Kampionatin Evropian "Pragë 2020". Distria Krasniqi dhe Loriana Kuka fituan medaljet e bronzta.



Katër klubet e Grupit B, në garë për kualifikim



MADRID, 8 DHJETOR (ER) - Një ndeshje e jashtëzakonshme do të zhvillohet sonte (e mërkurë): Real Madridi në Ligën e Kampioneve kundër Borussia Monchengladbachut në ndeshjen e fundit të Grupit B. "Los Blancos" aktualisht renditet i treti në grup pas pesë ndeshjeve, ndërsa Monchengladbachu kryeson grupin. Në garë për kualifikim janë edhe Shakhtar Donetsk dhe Interi. Moskalimi i grupit nga Real Madridi do të ishte edhe fundi i Zinedine Zidane's në krye të kësaj skuadre, por Reali e ka në duart e veta fatin e kualifikimit. "Duam tri pikë dhe të përfundojmë si lider i grupit. Jam i bindur se do të kemi ndeshje të mirë", ka thënë Zidane.

Trajneri francez tutje bëri me dije se nuk është duke menduar për të ardhmen ngaqë vendimi i takon klubit. "Klubi do të bëjë çfarë duhet, nuk mendoj për këtë. Jam duke menduar për ndeshjen e radhës që t'ia dalim mirë dhe t'i marrim tri pikë", ka deklaruar Zidane. Reali me fitore do të kualifikohet në raundin e ardhshëm, kurse skuadra e dytë në tabelë, Shakhtar, përballet me skuadrën e fundit, Interin. Cilado skuadër që fiton do të kualifikohet. Lajm i mirë për skuadrën e Zidane's është rikthimi i kapitenit Sergio Ramos, kurse mungojnë Eden Hazard dhe Dani Carvajal. Nico Elvedi dhe Tony Jantschke i mungojnë skuadrës gjermane, kurse Ramy Bensebaini është në dyshim.

GRUPI A		
21:00 Bayern M. - Lokomotiv Moscow		
21:00 Salzburg - Atletico Madrid		
Tabela		
1. Bayern M.	5	Pikë 13
2. Atletico M.	5	6
3. Lokomotiv M.	5	4
4. Salzburg	5	3
GRUPI B		
21:00 Inter - Shakhtar Donetsk		
21:00 Real Madrid - B. Moenchengladbach		
Tabela		
1. B. Moenchengladbach	5	Pikë 8
2. Shakhtar D.	5	7
3. Real M.	5	7
4. Inter	5	5
GRUPI C		
21:00 Manchester City - Marseille		
21:00 Olympiacos - Porto		
Tabela		
1. Manchester City	5	Pikë 13
2. Porto	5	10
3. Olympiacos	5	3
4. Marseille	5	3
GRUPI D		
18:55 Ajax - Atalanta		
18:55 Midtjylland - Liverpool		
Tabela		
1. Liverpool	5	Pikë 12
2. Ajax	5	8
3. Atalanta	5	7
4. Midtjylland	5	1

LeBron: Tani përgatitem për titullin tjetër

LOS ANGELOS, 8 SHTATOR - LeBron James dhe Lakersat përgatiten për një tjetër sezon të vështirë në NBA, ku do ta mbrojnë titullin e fituar pak muaj më parë. Sezoni 2020-2021 do të nisë më 22 dhjetor, vetëm pak ditë para Krishtlindjeve. "E pranoj, që do të dëshiroja t'i kaloja ato ditë me familjen. Nuk prisja që sezoni të niste kaq shpejt. Kisha caktuar pushimet me familjen, por planet ndryshuan", ka thënë LeBron. "Kam pak ditë që kam rinisur stërvitjen me ritëm të plotë dhe ende nuk jam në formë. Jam mësuar me problemet e vogla fizike. Ato nuk më kanë ndalur asnjëherë dhe nuk do të më ndalin tani. Jam në një moment të rëndësishëm të jetës time. Dua të vazhdoj të fitoj dhe frymëzoj njerëzit. Dua të luaj në nivele të larta, për veten, familjen, skuadrën dhe tifozët", u shpreh LeBron James.



Në lidhje me sezonin e ri, ylli i NBA-së ka deklaruar: "E di që të gjitha skuadrat do të luajnë për t'i mundur Lakersat këtë sezon. Pra, jemi në qendër të vëmendjes. Tani nis një sfidë e re dhe do të jemi gati.

Shqetësohem për atë që vjen, jo për atë që kaloi. Nuk kënaqemi me një titull, duam të triumfojmë sërish, këtë gjë e duan të gjithë në ekip dhe besoj se mund t'ia dalim mbanë", ka deklaruar "King James".

SHKURT

Tare: Shqipëria lufton për pozitën e dytë, Kosova mund të jetë befasia e grupit

Shqipëria dhe Kosova mësuan të hënën kundërshtarët e eliminatorëve të Botërorit "Katar 2022". Short "ferri" me kuqezinjë dhe dardanët, teksa goglat i rezervuan rivalë shumë të fortë, teksa do të duhet një mrekulli për të ëndërruar. Kuqezinjët e Edi Rejës "peshkuan" Anglinë, Poloninë, Hungarinë, Andorrën dhe San Marinon, ndërkohë që Kosova do të jetë në të njëjtin grup me Spanjën, Suedinë, Greqinë dhe Gjeorgjinë. Në lidhje me këtë short ka folur edhe ish-futbollisti i Kombëtares, Igli Tare, i cili aktualisht ushtron postin e drejtorit sportive te Lazio. "Shqipëria ndodhet në një grup më të vështirë. Mirëpo, unë besoj se do të luftoj për vendin e dytë, i cili realisht është i arritshëm me këta kundërshtarë që ka. Do të jetë shumë e vështirë për Kosovën, pasi do të ketë përballë kundërshtarë shumë të vështirë, mirëpo nëse gjen shpirtin e para dy vjetëve mund të jetë surpriza e grupit", ka thënë Tare për "Gazetën Sheshi".

Pogba do të largohet nga Unitedi

Mino Raiola, agjent i Paul Pogbas, ka lëshuar një deklaratë të fuqishme mbi të ardhmen e mesfushorit francez për të cilin ka thënë se periudha e tij me Manchester Unitedin ka përfunduar. Duke folur për gazetën italiane "Tuttosport", Raiola ka thënë: "Unë mund të them se ka mbaruar gjithçka ndërmjet Paul Pogbas dhe Manchester Unitedit". Unitedi dhe Pogba kurrë nuk gjetën një marrëveshje mbi zgjatjen e kontratës e cila skadon në vitin 2022.

Maldini: Milani lufton për titull

Drejtori teknik Paolo Maldini ka thënë se Milani është në luftën për ta fituar titullin e kampionit në Itali. "Ne nuk po kërkojmë të përmirësohemi, por për të arritur sukses. Sinqerisht nuk e kam pritur një ecuri të tillë, por e kam nuhatur këtë sukses qysh në janar, para se bota të mbyllej nga pandemia. Rezultatet e këtij viti na tregojnë se Milani do të luftojë për titull", ka thënë Maldini në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport".

Neueri lavdëron Mendyn

Portieri i Chelseas, Edouard Mendy, po rezulton një blerje e qëlluar nga blutë e Londrës. Gardiani nga Senegali ka mahnitur Premier Ligë me paraqitjet e tij dhe tashmë ai është një armë e fortë në formacionin e Frank Lampardit. I këtij mendimi është edhe Manuel Neueri, i cili e vlerëson së tepërmi 28-vjeçari. "Në ditët e sotme ka shumë portierë të klasës botërore. Për shembull, Edouard Mendy, i cili u transferua nga Rennes te Chelsea. Ai është një lojtar i cili luante në Ligën 1, por sapo kaloi në një klub të madh e vërtetoi se është sërish i suksesshëm", ka thënë Neuer për "L'Equipe".

Fury, Joshuas: Do të t'i thyej turinjtë

Tyson Fury ka kërcënuar se do t'ia thyej turinjtë Anthony Joshuas në një reagim ndaj komenteve të bashkatdhetarit të vet, i cili kishte thënë se Fury dëshiron të bëhet i famshëm dhe superyll. Joshuan nuk ka luftuar që prej se e rrahu Andy Ruizin në rimeçin e tyre në Arabinë Saudite në dhjetor të vitit të kaluar për t'i rifituar titujt e botës në kategorinë e rëndë në WBO, WBA dhe IBF. Ai do t'ia mbrojë titujt të shtunën e ardhshme kundër boksierit bullgar Kubrat Pulev. Duke folur para këtij meçi, Joshua ka thënë: "Mendoj se Fury duhet të vijë në Matchroom dhe 258 Management dhe të na lejojë t'ia rregullojmë karrierën. Ai është superyll, është duke u bërë superyll me menaxhimin e duhur". Fury që është kampion bote në divizionin e vetëm që i mungon Joshuas, WBC ka reaguar në rrjetet sociale ndaj komenteve të bashkëvendësit të vet: "Anthony Joshua, a nuk e ke kuptuar se unë nuk jam i interesuar të jem superyll dhe i famshëm? Unë jam luftëtar dhe jam i interesuar vetëm të t'ia thyej turinjtë. Po vij për ty, superyll. Tik-tak, tik-tak", ka shtuar Fury.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimet të Gjykatës Kushtetuese Nr. ref. AGJ 1583/2020, si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 450/2020 të datës 23.09.2020, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

VAZHDIM I KONKURSI Edhe për 7 (shtatë) ditë kalendarike

I. Zyrtar për Transport 3

Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca:	Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 002
Emri pozitës:	Zyrtar për Transport 3
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ
Grada:	12
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Kodi punës:	AD/1110
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pese pike pese (5.5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institucionit. Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta të lidhura me transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kryen punën e vozitjes së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;

Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar; Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;

Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;

Mban të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;

Kujdeset që automjetet e institucionit të përdoren në mënyrë sa më racionale;

Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;

Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë nga mbikëqyrësi.

Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet)

Njohuritë, shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së zyrtarit për transport 3;

Shkathësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioriteteve;

I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;

Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion.

Shkathësi në aplikacione të programeve Internet, Word, Excel.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Shkolla e mesme

Të posedojë patentë shofer për kategorinë "B".

Përvoja e Punës:

Së paku 3 vite përvojë pune.

Konkursi vazhdohet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 09.12.2020 deri me datë 15.12.2020 si datë e mbylljes së konkursit.

Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org

Aplikimi në mënyrë elektronike: Pas plotësimit, aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e skanuara të cilat kërkojnë sipas konkursit në formatin PDF, dokumentacioni dërgohet në postën elektronike: burimet.njerezore@rks-psh.org, ku me pas ju do të pranoni konfirmimin për dërgesën e aplikacionit tuaj në mënyrë elektronike.

Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerezore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi ose kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
3. Dy rekomandime (nëse kenë);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
5. Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Certifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.

Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislativonin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona Br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Kosova, Presude Ustavnog Suda Nr. ref. AGJ 1583/2020, kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova TSK/Br. 450/2020 datuma 23.09.2020, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

PRODUŽENJE KONKURSA Za još 7 (sedam) kalendarskih dana

I. Službenik za Transport 3

Osnovno Tužilaštvo Priština, jedna (1) pozicija

Referenca:	Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ -002
Naziv pozicije:	Službenik za Transport 3
Pozicija:	Pozicija karijere
Nivo:	Administrativno
Grada:	12
Raportira kod:	Administrator Tužilaštva
Kod rada:	AD/1110
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Koeficient:	Pet tačka pet (5.5)
Akt imenovanja:	Na neodređeno
Probni rad:	Dvanaest (12) meseci
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Pružanje usluga prevoza tužioca službenika i osoblja institucije.

Pažljiv za direktnim aktivitetima vezana za transport u instituciju i održavanje vozila.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Završava posao vozača tužilača i službenika na osnovu rasporeda službenih odredbi na nivou tužilaštva

Održava vozilo sa kojim završava službene obaveze ili sa kojim je zadužen

Prisutan u toku planiranja za pripremu programa na polju transporta i obezbeđuje održavanje poslova vezano za usluge transporta

Odgovoran je za obezbeđenje servisa i održavanja transportnih vozila institucije

Da drži evidenciju korišćenja, servisa vozila i spremi potrebnu dokumentaciju za njihovo korišćenje

Stara se da vozilo institucije da se koriste na racionalan način

Pružna usluge transporta po potrebi

Obavlja i druge zadatke u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje može zatražiti od strane nadzornik.

Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Potrebno profesionalno znanje za obavljanje zadataka Službenika za Transport 3;

Sposobnosti za određivanje i procenu posla po zadatim prioritetima

